



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.6.9-2013/15-08

RAPORTI I AUDITIMIT
SIGURIA NË PUNË E PUNONJËSVE NË SEKTORIN E
NDËRTIMTARISË

Auditim i Performancës

Prishtinë, Tetor 2016

Zyra Kombëtare e Auditimit, e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky raport vlerëson nëse është duke u punuar në krijimin e kushteve për të ofruar siguri në punë .

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit *“Siguria në Punë e Punonjësve në Sektorin e Ndërtimtarisë”* në konsultim me Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm Artan Venhari, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e u.d të udhëheqësit të departamentit Myrvete Gashi, i mbështetur nga Vlora Duraku (Udhëheqëse e ekipit) dhe Valmira Jonuzi (Anëtare).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1 Hyrje	6
2 Përshkrimi i sistemit për sigurinë dhe shëndetin në punë	10
3 Të gjeturat e auditimit.....	11
4 Krahasimi i Inspektorateve të Punës Kosovë - Maqedoni.....	14
5 Konkluzionet	17
6 Rekomandimet	18
Shtojca I: Struktura Organizative e TEIP	19
Shtojca II: Inspektorët nëpër regjionet e Kosovës	20

Lista e shkurtesave

ARBK	Agjencia e Regjistrimit te Bizneseve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
IP	Inspektori i Punës
ISHPM	Inspektorati Shtetërorë i Punës së Maqedonisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
TEIP	Trupa Ekzekutive e Inspektoratit te Punës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është rezultat i auditimit të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe fokus të veçantë ka aspektin e sigurisë në punë të punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sigurisë së punonjësve në punë dhe trendin e rritjes së lëndimeve dhe fatkeqësive të punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës në këtë fushë. Me këtë auditim ne synojmë që përmes rekomandimeve tona t'i nxisim akterët përgjegjës institucional në krijimin e parakushteve ligjore dhe teknike për rritjen e mirëqenies së punonjësve në punë.

Ne kemi verifikuar, nëse Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ka vendosur sistem funksional dhe efikas të kontrollit dhe nëse ka siguruar inspektime të mjaftueshme për të parandaluar lëndimet dhe fatkeqësitë e punonjësve në punë në sektorin e ndërtimtarisë.

Auditimi ynë ka identifikuar, që Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ende nuk ka zhvilluar procedura adekuate për parandalimin dhe mirë-administrimin e situatave emergjente në vendin e punës. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat statistikore të cilat tregojnë se në këtë sektor krahas sektorëve tjerë vazhdon të ketë numër më të madh të vdekjeve dhe lëndimeve të punëtorëve.

Mungon një planifikim dhe monitorim i mirëfilltë inspektimeve dhe i informimit të kompanive nga ana e Trupës Ekzekutive e Inspektoratit të Punës për përgatitjen e dokumentit mbi vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës si: procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit, raportimit dhe rishikimit të vazhdueshëm.

Me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit ekzistues, ne kemi dhënë rekomandimet tona për të siguruar një sistem më të mirë në sektorin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë.

Konkluzionet

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës si autoritet kyç për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk kanë arritur të zbatojnë plotësisht ligjin, rregulloret dhe standardet për këtë fushë. Për pasojë gjendja e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendin tonë ende nuk është në nivelin e pranueshëm.

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka arritur të përmbush plotësisht funksionin e saj sa i përket hartimit të legjislacionit dhe politikave për siguri dhe shëndet në punë. Ka miratuar katër rregullore, të cilat janë pjesërisht të aplikueshme. Më tutje, nuk ka themeluar Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, planin zhvillimor strategjikë dhe rregulloret përkatëse për këtë fushë. Mungesa e këtyre mekanizmave, tregon se ende nuk janë krijuar parakushtet për mbarëvajtjen e aktiviteteve të cilat do të siguronin sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve.

- Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ende nuk ka krijuar një sistem të menaxhimit dhe monitorimit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Mungesa e planeve vjetore dhe e inspektimeve efektive ka rezultuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Sistemi jo i qartë i raportimit ka dhënë efektet negative duke rezultuar me raportime të mangëta dhe të pa strukturuara. Për shkak të raportimit jo cilësor nuk janë siguruar informata për klasifikimin e aksidenteve për numrin e përgjithshëm të inspektimeve.
- Mungesa e trajnimeve adekuate, kapaciteteve njerëzore si dhe atyre teknike ka ndikuar që inspektorati i punës mos t'i kryej punët me efikasitet. Në mungesë të stafit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional vetëm një numër i kufizuar i bizneseve janë mbuluar me inspektime dhe si pasojë numri i aksidenteve dhe vdekjeve në punë vazhdon të rritet.

Rekomandimet

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës duhet të sigurojnë që përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara sipas ligjit, rregulloreve dhe standardeve për sigurinë në punë. Me theks, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtojnë çështjeve në vijim:

Rekomandimet për Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- Në afat sa më të shkurtër të hartoj rregullore për krijimin e parakushteve për Siguri dhe Shëndet në punë dhe të krijoj mekanizma për zbatimin e këtyre rregulloreve;
- Në afat prej gjashtë (6) muajsh të formoj Këshillin Nacional i cili do të mbikëqyr çështjet rreth sigurisë në punë për të punësuarit;
- Brenda vitit 2016 të aprovoj strategjinë zhvillimore për siguri dhe shëndet në punë;
- Të shqyrtoj mundësin e rritjes së kapaciteteve financiare, teknike dhe njerëzore të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës për t'i mundësuar përmbushjen e obligimeve ligjore; dhe
- Të rrit llogaridhënien dhe përgjegjësin ndaj Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës për të siguruar që përmbush obligimet e përcaktuara me ligj.

Rekomandimet për Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës:

- Dizajnon dhe vendos një sistem efikas të planifikimit, inspektimit në terren dhe monitorimit të inspektimeve. Aktivitetet e inspektimit duhet planifikohen dhe dokumentohen mirë, në mënyrë që performanca të jetë e matshme dhe aty ku vërehen ngecje të merren masa konkrete për përmirësimin e mangësive;
- Implementon raportim efektiv për inspektimet e kryera duke ofruar informacion sasior, cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qartë lidhur me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Raportet e inspektimit duhet të përmbajnë identifikimin dhe klasifikimin e rasteve aksidentale, sikur aksidentet e lehta, të rënda dhe fatale;

- Instalon një sistem efikas dhe efektiv të informimit të punonjësve, bizneseve dhe publikut në përgjithësi lidhur me kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë. Me theks, krijon ueb-faqen zyrtare për informim të rregullt dhe me mundësi qasje nga publiku, në të cilën do të mund të publikonte të dhëna periodike të inspektimit për aktivitetet dhe çështjet tjera mbi sigurinë në punë; dhe
- Siguron zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, përmes trajnimeve të vazhdueshme profesionale në bazë të standardeve të cilat i përgjigjen kërkesave dhe nevojave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përgjigja e Ministrit dhe Kryeinspektorit

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryeinspektori i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet tona, dhe është zotuar se do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Në vitin 2013, sektori i ndërtimtarisë ishte kontribuuesi i 6-të (gjashtë) më i madh i PBB (Prodhimi i Brendshëm Bruto), duke arritur kuotën prej 6.6%. Me një pjesëmarrje prej 9.5% sektori i ndërtimit ishte punëdhënësi i 4-të më i madh në Kosovë në vitin 2014, duke punësuar rreth 39,000 punëtorë¹. Aktualisht janë rreth 3,500 kompani ndërtimore në Kosovë dhe çdo vit nga rreth 800 ndërmarrës të rinj.

Siguria dhe shëndeti në punë duhet të garantohet në të gjitha degët e industrive, bizneseve dhe tregtive përfshirë industritë tradicionale, shërbimin kombëtar të shëndetit, kujdesin shtëpiak, shkollat, universitetet, objektet e rekreacionit dhe zyrat e ndryshme të punës.

Çdo punëdhënës është i obliguar për të ngritur standardin apo nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë për të punësuarit. Faktorët që përcaktojnë këtë janë: aspekti moral, ligjor dhe financiar.

Aspekti moral është i përqendruar në nevojën për të mbrojtur njerëzit nga lëndimet dhe sëmundjet deri sa ata janë në punë. Aspekti ligjor është i ndërlidhur me kornizën e aplikueshme ligjore. Ndërsa ato ekonomike apo financiare pasojnë si dënime për shkak të shkeljeve apo mos zbatimit të kërkesave ligjore, pagesave kompenzuese dhe kostot e tjera të ndërlidhura, madje në raste ekstreme mund të pasojnë edhe me burgosje.

Krijimi i kushteve për siguri dhe shëndet në punë ndikon në nxitjen e investimeve të jashtme. Me këtë investuesit sigurohen se respektohen të drejtat themelore të njeriut/punëtorëve, ligjet nacionale dhe standardet ndërkombëtare.

Një menaxhim efektiv i sigurisë dhe shëndetit në punë²:

- Është vital në mirëqenien e punëtorëve;
- Ka një rol pozitiv në ngritjen e reputacionit të biznesit dhe t'i ndihmojë atij të arrijë performancë të lartë ekipore; dhe
- Financiarisht është e dobishme.

Edukimi dhe trajnimi mbi çështjet e sigurisë në punë është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të krijuar sjellje të dëshirueshme nga ana e punëdhënësve, punëmarrësve dhe personave të vetëpunësuar. Auditimi ynë është orientuar në aspektin e sigurisë në punë me fokus të veçantë në Sektorin e Ndërtimtarisë, për shkak të numrit më të lartë të lëndimeve dhe vdekjeve të punëtorëve që janë shënuar në këtë sektor. Aktualisht, TEIP nuk disponon të dhëna të sakta zyrtare, mirëpo numri i punëtorëve që rrezikojnë çdo ditë shëndetin e tyre në vendet e punës është shqetësues³. Në shumë raste punëtorët nuk janë të pajisur me mjetet e domosdoshme mbrojtëse në punë dhe nuk kanë trajnime për përdorimin e mjeteve/makinerive që rrezikojnë drejtpërdrejt jetën e tyre⁴.

¹ Helvetas Swiss Intercooperation and DMA, Vlerësimi i Tregut për sektorin e ndërtimit 2015

² Praktikant e mira të rekomanduara nga United Kingdom (UK) Health and Safety Executive (HSE)

³ <http://gazetaexpress.com/lajme/vdes-51-vjeqare-ne-Ferizaj-ishte-ne-vend-te-punes-154647/>


⁴ Qendra për Politika dhe Avokim, Sfidat në zbatimin e ligjit të punës, Dhjetor 2012

Problemi i auditimit

Numri i aksidenteve të rënda dhe në shumicën e rasteve edhe me pasoja fatale për shëndetin e punëtorëve është shqetësues dhe është rritur nga viti në vit⁵.Pasojat nga mos zbatim i masave apo zbatim i pamjaftueshëm i rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë është problem shqetësues për njerëzit dhe natyrën në nivel global⁶.

Analizat e bëra kanë treguar se sektori i ndërtimitarisë prinë me numrin më të lartë të rasteve me lëndime por edhe me vdekje të punëtorëve. Bazuar në këtë, ne kemi përzgjedhur për trajtim këtë sektor, si një ndër sektorët më të ndjeshëm dhe me rrezik më të lartë krahas sektorëve tjerë. Më poshtë kemi prezantuar trendin e lëvizjes së numrit të lëndimeve në raport me vdekjet përgjatë pesë viteve të fundit.

Grafiku 1: Numri i lëndimeve dhe vdekjeve në Kosovë për periudhën 2011-2015



Në grafikun më lartë, shihet se numri i lëndimeve në sektorin e ndërtimit ka lëvizur çdo vit duke pasqyruar rënie pastaj rritje, me përjashtim të vitit 2014 që rezulton gati me dyfishim të lëndimeve, përderisa rastet me fatalitet kanë tendencë rënie. Duhet theksuar, se në mungesë të informatave të plota dhe zyrtare, nuk përjashtohet mundësia se mund të ketë edhe raste më të shumta të vdekjeve apo lëndimeve që nuk janë lajmëruar fare në inspektoratin e punës.

⁵ Raporti Vjetor, TEIP, shtypi ditor Koha.net dhe Shoqëria Civile për Raportin e Progresit 2014 EU-OSHA-Agjencia Evropiane për Siguri dhe Shëndet në punë(vende pune të shëndetshme 2012-13)

⁶ EU-OSHA- Agjencia Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Pune(vende Pune të Shendetshme2012-13)

Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi se sa TEIP është duke punuar në monitorimin e punëdhënësve, që për obligim kanë krijimin e kushteve të sigurisë në punë me qëllim të evitimit ose zvogëlimit të rasteve me pasoja të vdekjeve/lëndimeve të punëtorëve në vendin e punës.

Ky auditim synon të kontribuojë në rritjen e inspektimeve, rritjen e sigurisë në punë dhe zvogëlimin e rasteve të lëndimeve/vdekjeve.

Pyetjet e Auditimit

Për të kuptuar më mirë problemin e auditimit, për të arritur deri tek konkluzionet më të sakta dhe për të dhënë rekomandime më të zbatueshme ne do t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve:

- A ka krijuar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) parakushtet për të garantuar sigurinë në punë për punonjësit në sektorin e ndërtimtarisë?
- A janë vendosur mekanizma monitorues nga MPMS/TEIP për funksionimin e sistemit aktual të mbikëqyrjes?
- A posedon TEIP një plan të punës, udhëzues dhe kapacitete njerëzore për zhvillimin e aktiviteteve të tyre dhe cilat janë rezultatet e arritura?

Kriteret e Auditimit

Ky auditim do të vlerësojë legjislacionin në fuqi sa i përket sigurisë në punë, strategjisë zhvillimore, raportimit dhe performancës së TEIP.

Ne kemi përdorur kriteret në vijim në bazë të të cilave do të duhej të funksiononte TEIP:

- Strategjinë/Planin zhvillimor të Inspektoratit, Planin vjetor të punës, ligjet, politikat dhe rregulloret;
- Vendosjen e objektivave si dhe përcaktimin e prioritetëve me fokus në sektorët që rezultojnë me raste më të shpeshta të lëndimeve dhe rasteve me fatalitet;
- Planin operativ dhe organizativ për inspektime;
- Vlerësimet dhe analizat e bëra nga TEIP për sigurinë në punë;
- Performancën për shërbimet e ofruara nga TEIP;
- Plotësimi i Standardeve/kritereve minimale mbi kryerjen e shërbimeve të kompanitë e ndërtimit; dhe
- Krahasimin me vendet rajonale.

Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Fushëveprimi i këtij auditimi është fokusuar në TEIP, dhe zyrat e koordinatorëve regjional dhe ka qenë i orientuar kryesisht në përgjegjësitë dhe funksionet, si dhe mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave ligjore për “Sigurinë në punë të punonjësve”.

Auditimi ynë është orientuar në aspektin e sigurisë në punë me fokus të veçantë në Sektorin e ndërtimtarisë. Auditimi ka përfshirë Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës (TEIP) si dhe zyrat regjionale ku kryejnë punën koordinatorët regjional dhe Inspektorët e Punës.

Ky auditim ka mbuluar periudhën 2013-2014 si dhe përfshinë aktivitetet e ndërmarra në vitin 2015. Për çështje të analizave të trendëve janë mbuluar 5 vite (2011-2015). Po ashtu si pikë krahasuese ndërmjet punës së inspektorateve kemi marr një nga vendet e rajonit- Maqedoninë përkatësisht Inspektoratin Shtetëror të Punës së Maqedonisë (ISHPM).

Auditimi ynë trajton punën dhe funksionimin e organeve që deri tani janë të vendosura.

Aktivitetet e ekipit të auditimit përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

- Analizimin e të gjitha dokumenteve relevante, siç janë Plani Strategjik dhe zhvillimor, Planin Vjetor të punës, etj.
- Shqyrtimi dhe krahasimi i raporteve vjetore të TEIP për vitet 2011-2015;
- Procedurat e punës për kryerjen e inspektimeve;
- Raportet individuale të inspektimeve;
- Raportet vlerësuese për monitorim;
- Analiza e shkaktarëve të lëndimeve/vdekjeve të bëra nga TEIP;
- Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës në TEIP, koordinatorët regjional dhe disa kompani private ndërtimore;
- Vëzhgimin e inspektimeve të kryera nga TEIP;
- Përdorimin e pyetësorëve për TEIP në disa kompani ndërtimore; dhe
- Raporte dhe dokumente tjera relevante rreth statistikave për lëndimet/vdekjet në sektorin e ndërtimtarisë.

2 Përshkrimi i sistemit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Roli i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

MPMS krijon politikat e punës dhe të mirëqenies sociale si dhe harton dhe zbaton legjislacionin për këto fusha. Vendos standarde për siguri dhe shëndet në punë të të punësuarve dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës

TEIP funksionon në kuadër të MPMS dhe është përgjegjëse për koordinimin e veprimeve ekzekutive sa i përket inspektoratit të punës në Kosovë, dhe për të siguruar se procedurat dhe kërkesat ligjore relevante po zbatohen nga punëdhënësit.

Punëdhënësi duhet në vazhdimësi të përmirësojë kushtet e punës dhe të ngritë nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjesisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

TEIP funksionon nën autoritetin e MPMS, udhëhiqet nga Kryeinspektori i Punës, i cili për punën e inspektoratit që udhëheq është i obliguar që ti raportojë Ministrit të MPMS. Për më tepër referoju shtojcës I ku është paraqitur Struktura Organizative e TEIP.

TEIP funksionin e vet e ushtron në 7 (shtatë) regjione me gjithsej 38 komuna në tërë territorin e Kosovës. Në shtojcën II është paraqitur numri i Inspektorëve në regjione.

Akterët tjetër

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) - aktivitet kryesor e ka regjistrimin e bizneseve dhe licencimin e kompanive për sektorin e ndërtimit.

3 Të gjeturat e auditimit

Sistemi i mbikëqyrjes, korniza ligjore dhe menaxhimi profesional për sigurinë në punë

MPMS është përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave legislative dhe rregullimit të lëmisë së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe është përgjegjëse për vendosjen e standardeve dhe bën mbikëqyrjen e tyre.

TEIP duhet të kryej funksionet e saja të cilat kërkohen me Ligjin për Inspektoratin e punës në Kosovë dhe ligjin për siguri në punë i cili është në harmoni me Direktivën Kornizë të Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE). Nga kjo Direktivë Kornizë burojnë edhe shumë direktiva tjera individuale të cilat duhet t'i harmonizojmë me rregulloret e BE.

- MPMS deri më tani ka hartuar dhe aprovuar katër rregullore relevante për siguri dhe shëndet në punë mirëpo dy prej tyre janë pjesërisht të aplikueshme⁷.
- Kërkesë e ligjit për siguri në punë është themelimi i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë si organ këshillëdhënës i Qeverisë⁸. Sipas zyrtarëve të TEIP, procedurat për themelim të Këshillit janë kryer, mirëpo ende nuk është proceduar në Qeveri. MPMS ka përgatitur draft planin Strategjik Zhvillimor për vitin 2015-2020, përmes së cilës janë përcaktuar synimet zhvillimore të IP-së, mirëpo deri në përfundim të auditimit kjo strategji ende nuk është miratuar nga Ministri.

Draft plani strategjik zhvillimor parashton vizionin, misionin, objektivat strategjike, veprimet për realizimin e këtyre qëllimeve, duke përfshirë edhe afatet kohore dhe realizimin e tyre. Ky projekt parasheh edhe nevojën për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e realizimit të objektivave të përcaktuara në planin operativ.

Menaxhimi nga TEIP për sigurinë në punë dhe kryerja e inspektimeve

Plani strategjikë duhet të shërbejë si kornizë për planifikim në nivel më të përgjithësuar i cili duhet të mbështetet nga planet vjetore specifike të matshme për zbatimin e atij plani.

- TEIP nuk ka hartuar dokument apo plan vjetor të mirëfilltë të inspektimeve, nuk ka as prioritet të tyre, inspektimet kryhen në mënyrë të rastësishme pa plan paraprak. Nuk ka as vlerësim të sektorëve më me rrezik, gjë e cila do të ndihmonte në planifikim adekuat. Sipas analizave tona sektori i ndërtimeve është një ndër sektorët me rrezik më të lartë dhe me pasoja më të rënda, sektor ky që do të duhej dhënë prioritet më i lartë për inspektim nga TEIP krahas sektorëve tjerë.


⁷ Sipas MPMS dhe TEIP Rregulloret pjesërisht të aplikueshme janë : Nr.02/2014 dhe Nr.03/2014

⁸ Detyrat e këshillit janë propozimi, rekomandimi dhe hartimi i politikave për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe që duhet të përcjell në vazhdimësi gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve.

- TEIP nuk ka hartuar raporte individuale të monitorimit. Në mungesë të tyre ne nuk kemi arritur të vlerësojmë efikasitetin e angazhimeve dhe rezultateve të punës. Nuk ishin identifikuar dhe analizuar shkaktarët apo arsyet e rasteve të lëndimeve dhe vdekjeve në punë.
- TEIP ka inspektuar vetëm një numër të vogël të bizneseve. Në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve deri në fund të vitit 2015 ishin të regjistruara 126,625 biznese⁹, ndërsa inspektorati i punës ka arritur t'i inspektoj vetëm 7% të tyre, pa llogaritur këtu edhe punëdhënësit e sektorit publik.
- TEIP nuk disponon me regjistër të plotë apo evidencë të saktë nga ARBK-ja rreth numrit të kompanive ndërtimore të regjistruara e që zhvillojnë aktivitetet e tyre biznesore, dhe as evidencë të saktë se sa kompani janë vizituar për inspektim gjatë vitit.

Në vijim po paraqesim grafikun e inspektimeve të kryera për sigurinë në punë në sektorin e ndërtimtarisë për periudhën 2011-2015.

Grafiku 2. Numri i inspektimeve të kryera në Kosovë



Pjesë e punës sonë audituese ishin edhe vizitat tek kompanitë e ndërtimit dhe informimi rreth çështjeve dhe sfidave me të cilat ato kompani përballën gjatë aktiviteteve të përditshme.

Nga vizitat në kompanitë ndërtimore ne kuptuam se:

- Ekziston nevoja për vizita mbikëqyrëse më të shpeshta nga IP;
- Këshilla dhe informata rreth obligimeve të tyre ligjore;
- Shpërndarje më e madhe e informatave, për shkak se disa prej kompanive nuk ishin në dijeni se obligohen që të njoftohet TEIP në rast aksidenti të ndonjë punëtori; dhe
- Informimi i punëtorëve në përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

⁹ Sipas ARBK në Kosovë janë regjistruar deri më 31/12/2015 rreth 143,508 kompani, prej tyre janë c' regjistruar 16,884 biznese, ndërsa sipas ATK numri i bizneseve aktive deri me 31/12/2015 ishte 80,775 pa persona fizikë.

Raportimi i inspektimeve të kryera nga TEIP

Për t'i mundësuar menaxhmentit të TEIP kontroll mbi mbarëvajtjen e proceseve dhe për të marrë masa parandaluese apo korigjuese duhet të ekzistojë një raportim i rregullt dhe i detajuar. Një raportim i detajuar do t'i mundësonte edhe përcjelljen e përbushjes së objektivave organizative.

- TEIP ka kryer raporte vjetore mbi inspektimet e kryera për siguri në punë. Mirëpo, ende nuk ka vendosur një sistem të qartë të raportimit, siç përcaktohet me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Nuk ka raporte konkrete analitike mbi numrin e planifikuar të inspektimeve, realizimin e tyre, dobësitë apo problemet me të cilat janë përballur subjektet të cilat janë inspektuar, në mënyrë që të shërbejnë si dokument zyrtar apo mësim për proceset e ardhme.
- TEIP nuk posedon ueb-faqe zyrtare për informim të rregullt dhe mundësi qasje nga publiku, në të cilën do të mund të publikonte të dhëna periodike të inspektimit për aktivitetet dhe çështjet tjera mbi sigurinë në punë.

Mungesën e raportimeve zyrtarët e TEIP e arsyetojnë se nuk disponojnë me ndonjë aplikacion apo program kompjuterik (softver) përmes të cilit do të krijohet një bazë e të dhënave ku do të mundësohet konsolidimi i informatave relevante të cilat do të dokumentoheshin dhe do të mund të përdroeshin si bazë për vendimmarrje dhe si proces i planifikimeve për të ardhmen.

Licencimi dhe organizimi i trajnimeve për inspektorët e sigurisë në punë

Duke pasur parasysh rëndësinë e shëndetit dhe sigurisë në punë, inspektorët e punës duhet të përgatiten profesionalisht me anë të trajnimeve të avancuara për fushat përkatëse.

- TEIP nuk ka një sistem të organizuar të trajnimeve profesionale për inspektorët e punës e në veçanti për sigurinë në punë. Të vetmet trajnime që janë organizuar janë mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Trajnimet ishin zhvilluar gjatë viteve 2013-2015 dhe kishin për qëllim përmirësimin e kapacitetit të TEIP për monitorim efikas, zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë etj.

Sfidat e inspektoratit të punës

Sipas zyrtarëve, TEIP-it në vazhdimësi ka pasur vështirësi në ushtrimin e funksionit të tij për çështjet në vijim: kapacitete të pamjaftueshme njerëzore, teknike dhe logjistike, mungesa e zyrave dhe përgatitja e pamjaftueshme e inspektorëve në ushtrimin e detyrave të veta.

- Mungesa e kapaciteteve teknike (automjeteve) është një ndër faktorët që ka ndikuar në mosrealizimin e inspektimeve të mjaftueshme. TEIP disponon me 12 vetura¹⁰ që shërbejnë inspektorët për kryerjen e punës në teren. Ky numër i veturave është i pamjaftueshëm për plotësimin e nevojave dhe kryerjen e punëve në mënyrë efektive dhe efikase.

¹⁰ Sipas Inspektoratit të Punës

Me gjithë zhvillimet aktuale të sektorit të ndërtimitarisë dhe nevojës për inspektim nga ana e TEIP, numri i inspektorëve ka mbetur i njëjtë që nga viti 2011 deri në vitin 2015. Numri aktual është i pamjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet dhe për të siguruar se punëdhënësit përmbushin kërkesat ligjore në sigurimin e kushteve të sigurta për shëndetin e të punësuarve.

4 Krahasimi i Inspektorateve të Punës Kosovë - Maqedoni

Për qëllime krahasimi dhe marrjen e praktikave të mira ne kemi vizituar Inspektoratin Shtetëror të Punës në Maqedoni (ISHPM).

ISHP në Maqedoni përgatit planet vjetore duke u bazuar në fushat më të rëndësishme dhe me rrezik më të lartë, të ndara sipas veprimtarive sezonale, planin kohor dhe numrin e inspektimeve, për dallim nga Kosova që nuk ka përgatitur një plan bazuar në fushat me prioritet më të lartë dhe të përcaktuar me afate kohore.

TEIP në Kosovë nuk ka ueb-faqe zyrtare ku do të pasqyronte informatat relevante dhe me interes për akter të ndryshëm për fushat përkatës që i mbulon. Në anën tjetër, ueb-faqja zyrtare e ISHPM vazhdon të jetë çdoherë e azhurnuar me informata të ndryshme mbi numrin e inspektimeve të realizuara për ditë, javë, muaj, vite dhe shumë informata tjera. Gjithashtu edhe numri kontaktues pa pagesë është në dispozicion për të denoncuar parregullsitë dhe rastet e shkeljeve ligjore si nga punëdhënësit apo të punësuarit.

TEIP posedon 12 vetura për kryerjen e aktiviteteve operative, përderisa ISHPM ka në dispozicion 50 vetura për kryerjen e inspektimeve.

ISHPM me rastin e punësimit të inspektorëve kanë të vendosur si kriter përgatitjen profesionale në fusha të caktuara. Përveç kësaj, duhet të jenë të licencuar në fushën e sigurisë në punë, që është i ndarë si sektor nga ai i marrëdhënies së punës dhe shëndetit. Inspektorët e njërës fushë nuk mund t'i kryejnë inspektimet e fushës tjetër sepse nuk konsiderohen si të specializuar. Ndërsa në TEIP i njëjti inspektor i kryen të tri lëmit: marrëdhëniet në punë, sigurinë në punë dhe atë të shëndetit.

Numri i inspektimeve në Maqedoni është dukshëm më i lartë krahasuar me atë të Kosovës. Në Maqedoni kryhen një numër i konsiderueshëm i inspektimeve ndaras në lëmin e sigurisë në punë, sektor ky i ndarë dhe ka të bëjë vetëm me çështje sigurie.

Sa i përket inspektimeve të sigurisë në punë, Maqedonia në krahasim me Kosovën posedon inspektorët e specializuar për këtë fushë¹¹. Prej 99 inspektoreve, 36 janë të specializuar vetëm për fushën e sigurisë në punë dhe janë me përgatitje të ndryshme profesionale¹². Ndërsa nga 50

¹¹ Sipas ISHPM-së

¹² Në ISHPM Inspektorët e sigurisë janë të specializuar vetëm në këtë lëmi

inspektorë që ka TEIP në Kosovë¹³, vetëm 5 prej tyre janë inxhinierë dhe gjithë të tjerët janë me përgatitje të përgjithshme-jurist.

Në tabelën në vijim kemi paraqitur të dhënat/informatat për numrin e përgjithshëm të inspektimeve, numrin e inspektorëve dhe mesataren e inspektimeve për inspektor.


Tabela 1: Krahasimi mes Kosovës dhe Maqedonisë

Vitet	2011		2012		2013		2014		2015	
	Maqedoni	Kosovë	Maqedoni	Kosovë	Maqedoni	Kosovë	Maqedoni	Kosovë	Maqedoni	Kosovë
Krahasimet										
Gjithsej Inspektimet	33,146	6,396	36,270	7,074	45,885	8,378	48,525	9,337	49,311	9,505
Numri i inspektorëve gjithsej	99	50	107	50	107	50	107	50	114	50
Inspektimet vetëm për Shëndet dhe Siguri	14,419	/	14,473	/	16,594	/	18,117	/	17,412	/
Inspektimet vetëm ne Sektorin e Ndërtimtarisë	/	/	645	/	1,149	/	449	/	470	/
Inspektoret vetëm për Shëndet dhe Siguri	36	/	35	/	36	/	36	/	37	/
Mesatarja e inspektimeve për inspektor	335	128	339	141	429	166	454	187	433	190

Nga tabela e mësipërme vërehet numër shumë më i madh i inspektimeve për inspektor në Maqedoni në krahasim me Kosovën.

¹³ Sipas TEIP

Grafiku 3: Krahasimi Kosovë- Maqedoni për numrin e inspektimeve të kryera për vitet 2011-2015



Po të analizohen trendët e inspektimeve në mes Maqedonisë dhe Kosovës, për periudhën 2011-2015 në Maqedoni kemi mesatarisht 82% më shumë inspektime. Derisa në Kosovë numri i inspektimeve kishte tendencë rritje të lehtë nga viti 2014-2015.

Krahasimi i bërë për vitin 2015 nxjerr në pah dallimin e inspektimeve për inspektor. Në Kosovë një inspektor kishte kryer 190 inspektime në vit, ndërsa në Maqedoni 460 inspektime apo 63% më shumë inspektime se në Kosovë.

Sa i përket programit kompjuterik (softuerit) as Kosova e as Maqedonia nuk posedojnë një program të tillë, por për dallim nga Kosova, Maqedonia të dhënat i përditëson dhe mirëmban në Excel dhe raportimi është në nivel të kënaqshëm.

5 Konkluzionet

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës si autoritet kyç për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk kanë arritur të zbatojnë ligjin, rregulloret dhe standardet për këtë fushë. Për pasojë gjendja e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendin tonë ende nuk është në nivelin e pranueshëm.

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka arritur të përmbush plotësisht funksionin e saj sa i përket hartimit të legjislacionit dhe politikave për siguri dhe shëndet në punë. Ka miratuar katër rregullore, të cilat janë pjesërisht të aplikueshme. Më tutje, nuk ka themeluar Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, planin zhvillimor strategjikë dhe rregulloret përkatëse për këtë fushë. Mungesa e këtyre mekanizmave, tregon se ende nuk janë krijuar parakushtet për mbarëvajtjen e aktiviteteve të cilat do të siguronin sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve.
- Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ende nuk ka krijuar një sistem të menaxhimit dhe monitorimit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Mungesa e planeve vjetore dhe e inspektimeve efektive ka rezultuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Sistemi jo i qartë i raportimit ka dhënë efektet negative duke rezultuar me raportime të mangëta dhe të pa strukturuara. Për shkak të raportimit jo cilësorë nuk janë siguruar informata për klasifikimin e aksidenteve për numrin e përgjithshëm të inspektimeve.
- Mungesa e trajnimeve adekuate, kapaciteteve njerëzore si dhe atyre teknike ka ndikuar që inspektorati i punës mos t'i kryej punët me efikasitet. Në mungesë të stafit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional vetëm një numër i kufizuar i bizneseve janë mbuluar me inspektime dhe si pasojë numri i aksidenteve dhe vdekjeve në punë vazhdon të rritet.

6 Rekomandimet

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës duhet të sigurojnë që përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara sipas ligjit, rregulloreve dhe standardeve për sigurinë në punë. Me theks, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtojnë çështjeve në vijim:


Rekomandimet për Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- Në afat sa më të shkurtër të hartoj rregullore për krijimin e parakushteve për Siguri dhe Shëndet në punë dhe krijon mekanizma për zbatimin e këtyre rregulloreve;
- Në afat prej gjashtë (6) muajsh të formoj Këshillin Nacional i cili do të mbikëqyr çështjet rreth sigurisë në punë për të punësuarit;
- Brenda vitit 2016 të aprovoj strategjinë zhvillimore për siguri dhe shëndet në punë;
- Të shqyrtoj mundësin e rritjes së kapaciteteve financiare, teknike dhe njerëzore të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës për të përmbushur obligimet ligjore; dhe
- Rrit llogaridhënien dhe përgjegjësin ndaj Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës për të siguruar që përmbush obligimet e përcaktuara me ligj.

Rekomandimet për Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës:

- Dizajnon dhe vendos një sistem efikas të planifikimit, inspektimit në terren dhe monitorimit të inspektimeve. Aktivitetet e inspektimit duhet planifikohen dhe dokumentohen mirë në mënyrë që performanca të jetë e matshme dhe aty ku vërehen ngecje të merren masa konkrete për përmirësimin e mangësive;
- Implementon raportim efektiv për inspektimet e kryera duke ofruar informacion sasior, cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qartë lidhur me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Raportet e inspektimit duhet të përmbajnë identifikimin dhe klasifikimin e rasteve aksidentale, sikur aksidentet e lehta të rënda dhe fatale;
- Instalon një sistem efikas dhe efektiv të informimit të punonjësve, bizneseve dhe publikut në përgjithësi lidhur me kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë. Me theks, krijon ueb-faqen zyrtare për informim të rregullt dhe me mundësi qasje nga publiku, në të cilën do të mund të publikonte të dhëna periodike të inspektimit për aktivitetet dhe çështjet tjera mbi sigurinë në punë; dhe
- Siguron zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, përmes trajnimeve të vazhdueshme profesionale në bazë të standardeve të cilat i përgjigjen kërkesave dhe nevojave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Shtojca I: Struktura Organizative e TEIP



Shtojca II: Inspektorët nëpër regionet e Kosovës

Rajoni i Prishtinës	19 inspektorë	12 në Prishtinë, 2 në Podujevë, 1 në Drenas 1 në Lipjan, 1 në Graçanicë, 2 në Obiliq
Rajoni i Prizrenit	5 inspektorë	2 në Prizren, 1 në Dragash, 1 në Malishevë 1 në Rahovec
Rajoni i Pejës	7 inspektorë	6 në Pejë, 1 në Klinë
Rajoni i Ferizajt	6 inspektorë	3 në Ferizaj, 1 në Shtërpce, 1 në Kaçanik 1 në Shtime
Rajoni i Gjilanit	6 inspektorë	3 në Gjilan, 1 në Viti, 2 në Kamenicë
Rajoni i Mitrovicës	4 inspektorë	2 në Mitrovicë, 1 në Vushtrri, 1 në Skenderaj
Rajoni i Gjakovës	3 inspektorë	3 në Deçan